

Бр. 08 - 306/1
09.04 2025 год
ВЕЛЕС

SHMK "Gjimnazi Koço Racin" – Veles



Bazuar në nenin 42 të Ligjit për arsimin e mesëm (Gazeta Zyrt. e R.së Maqedonisë së Veriut nr.67/17... 229/20) Konkursi për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme publike për vitin shkollor 2025/26 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i publikuar nga Ministria e Arsimit Shkencës, Komisioni i Shkollës së SHMK "Gjimnazi Koço Racin" – Veles, për regjistrimin e nxënësve në vitin shkollor 2025/26, e publikoi këtë:

SHPALLJE

Në SHMK "Gjimnazi Koço Racin"-Veles në vitin shkollor 2025/26 në vitin I do të regjistrohen 136 nxënës në 4 paralele (102 nxënës në 4 paralele me mësimdhënie në gjuhën maqedone dhe 34 nxënës në 1 paralele me mësimdhënie në gjuhën shqipe) sipas planeve dhe programeve mësimore të arsimit gjimnazor.

Arsimimi gjimnaz -136 nxënës, 4 paralele, minimum 60 pikë

Maqedonisht -68 nxënës, 2 paralele

Shqip-34 nxënës, 1 paralele

Arsimimi gjimnaz -34 nxënës, 1 paralele, minimum 60 pikë

(paralelja bilinguale anglisht-maqedonisht) Maqedonisht -34 nxënës, 1 paralele

Gjatë aplikimit për arsimim në gjimnaz nxënësit duhet edhe gjatë vetregjistrimit të vendosin, për lëminë dhe kombinimin e përshtatshëm (A ose B) varësisht dëshirave të tyre.

- a. Drejtimi matematiko-natyror (kombinimi A)
- b. Drejtimi matematiko-natyror (kombinimi B)
- c. Drejtimi humanitaro-shoqëror (kombinimi A)
- ç. Drejtimi humanitaro-shoqëror (kombinimi B)
- d. Drejtimi gjuhësor-artistik (kombinimi A)
- dh. Drejtimi gjuhësor-artistik (kombinimi B)

Kushtet për regjistrim të nxënësve:

- « të kenë kryer arsimin fillor
- « të mos jenë më të vjetër se 17 vjet
- « të jenë të përcaktuar për plane dhe programe të arsimit gjimnaz
- « t'i plotësojnë kriteret të caktuara me konkurs
- « të posedojnë minimum 60 pikë

« Nxënësit me përkatësi etnike rome mund të regjistrohen nëse kanë deri në 10% më pak pikë sesa numri i pikëve të parashikuara sipas Konkursit për planet dhe programet e përshtatshme mësimore.



Kriteret për zgjedhjen e nxënësve

« Nota mesatare e nxënësit nga klasa VI deri në klasën IX maksimumi 50 pikë (suksesi i përgjithshëm nga klasa e gjashtë, shtatë, tetë dhe nëntë, pjestohet me katër dhe i njëjti numër shumëzohet me koeficient 10).

« Nota mesatare nga katër lëndë gjuhë amtare, gjuhë e huaj dhe dy lëndët e rëndësishme për drejtimin - (maksimumi 20 pikë-5 pikë për çdo lëndë)

« Diplomat për vendin e I-rë, II-të dhe III-të të fituar në garat ndërkombëtare dhe shtetërore në gjuhë amtare, gjuhë të huaj, shkenca natyrore, matematikë, kimi, fizikë, biologji dhe gjeografi dhe lëndë mësimore që janë të rëndësishme për lëminë që e ka zgjedhur. Për shpërblim të parë ose medalja e artë në garë ndërkombëtare 5 pikë, shpërblimi i dytë ose medalja e argjend 4 pikë dhe shpërblimi i tretë apo medalja e bronzit 3 pikë. Për fitimin e vendeve në gara shtetërore: për vendin I 3 pikë, për vendin II 2 pikë dhe për vendin III 1 pikë.

« Vlera mesatare e pikëve të fituara për sjelljen nga klasa e VI deri në klasën IX maksimumi 5 pikë (Sjellja shembullore vlerësohet me 5 pikë, Sjellja mirë vlerësohet me 3 pikë dhe Sjellja pakënaqshëm vlerësohet me 0 pikë. Vlera mesatare është shumë e sjelljes nga klasa e gjashtë, shtatë, tetë dhe nëntë e pjestuar me 4).

Dokumentet e duhura

Pas publikimit të listës preliminare, nxënësit që janë në listë paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

« Fletëparaqitja për regjistrim (fletëparaqitja për regjistrim hartohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit)

« Deftesat origjinale nga klasa VI deri në klasën IX

« Diploma (nëse nxënësi i ka) nga vendet e fituara (I, II, III) në garat ndërkombëtare dhe shtetërore në gjuhë amtare, gjuhë të huaj, shkenca natyrore, matematikë, kimi, fizikë, biologji dhe gjeografi dhe lëndë mësimore që janë të rëndësishme për lëminë, drejtimin që e ka zgjedhur)

« Çertifikata e lindjes (pa marrë parasysh datën e lëshimit)

Afatet e regjistrimit

« Paraqitja dhe regjistrimi i nxënësve do të zhvillohet në një afat regjistrimi me dy paraqitje në muajin qershor.

« Regjistrimi i nxënësve do të bëhet përmes aplikacionit elektronik, përmes lidhjes në portalin e shërbimeve elektronike të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në <https://e-uslugi.mon.gov.mk> me hyrje të veçantë për nxënësit e shkollave të mesme përmes llogarive të tyre të përdoruesve të Schools.mk.



AFATI I REGJISTRIMIT-QERSHOR, PARAQITJA I

« Paraqitja e parë në mënyrë elektronike do të zhvillohet prej në ora 00.00 më 14 qershor deri në ora 23.59 më 17 qershor 2025 .

« Pranimi i dokumenteve në shkollë do të zhvillohet më 18 qershor 2025 prej në ora 08.00 deri në ora 19.00 dhe më 19 qershor 2025 prej në ora 08.00 deri në ora 17.00 .

« Lista përfundimtare e renditjes me rezultatet e regjistrimit dhe vendet e disponueshme do të publikohet më 20 qershor 2025, më së voni në ora 12:00 në tabelën e njoftimeve të shkollës.

AFATI I REGJISTRIMIT-QERSHOR, PARAQITJA II

« Paraqitja e dytë në mënyrë elektronike do të zhvillohet më 30 qershor 2025 prej në ora 00.00 deri në orën 23.59.

« Dorëzimi i dokumenteve do të zhvillohet më 01 korrik 2025 prej në ora 10.00 deri në ora 19:00 dhe

« Lista përfundimtare e renditjes me rezultatet e regjistrimit dhe vendet e disponueshme do të publikohet më 2 korrik 2025, më së voni deri në ora 12:00 në tabelën e shpalljeve të shkollës.

AFATI I REGJISTRIMIT GUSHT

«Nxënësit që dërgohen në provime plotësuese, provim vjetor, provime për avancim më të shpejtë, mund të regjistrohen në shkollat ku ka vende të lira pas afatit të qershorit.

«Paraqitja e nxënësve do të bëhet në datën 21 gusht 2025 prej në ora 00:00 deri në ora 15:00 në mënyrë elektronike.

«Dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm në shkollë do zhvillohet në datë 21 gusht 2025 nga ora 08.00 deri në orën 17.00.

«Lista përfundimtare e renditjes me rezultatet e regjistrimit do të publikohet më 22 gusht 2025, jo më vonë se ora 10:00 në tabelën e njoftimeve të shkollës.

Pas publikimit të Listës përfundimtare të renditjes me rezultatet e regjistrimit, nxënësit të cilët nuk janë regjistruar në shkollë detyrimisht e tërheqin të gjithë dokumentacionin e dorëzuar në shkollë brenda 24 orëve dhe shkollat janë të detyruara t'ua kthejnë të gjithë dokumentacionin nxënësve brenda 24 orëve.

DREJTOR:

ILIJA POPOV

